

BIBLIOTEKA
SHTETIT

824-1
1498

Meto
Muho

Dasme
partizane

vjersha



Ka lindur në Lekdush të Kurveleshit më 1923 në një familje të varfër fshatare. Qysh në moshë të re ka punuar shërbyses dhe punëtor. Më 1942 hyri në Lëvizjen nacionalealçirimitare dhe mori pjesë në aksionet kundër ushtrisë faqiste. Në 1943 doli partizan, në batalionin «Margarita Tutuanî» dhe pastaj në batalionin «Abaz Shehu» të Brigadës VI Sulmuese. Mori pjesë në gjithë luftimet që zhvilloi brigada duke kaluar edhe në tokat e Jugosllavisë. Ka luftuar edhe në provokacionet e gushtit të vitit 1949.

Ky është vëllimi i tij i dytë me vjersha.

884-1
MSS

METO MUHO

DASME PARTIZANE

— vjersha —



Rezultati: VJERSHA SLENDREHE
Kopuesaq eza: MUSA QANI

Lloksi: 1000 fjalë Lloimi: 10x15 cm Gjatësi: 330x175

Shtyp: Djalotja Çështjeve Të Përgjigjet

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

SHTRYP SHKRONJA

Redaktor: VEHBI SKENDERI

Kopertina nga: MUSA QARRI

Tirazhi 1.500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike

Shtyposhkronja 8 NENTORI — Tirane, 1973.

BIE BORA FLOKE—FLOKE

Bie bora flokë-flokë dhe nuk ndihet,
s'duket qiel, s'duket tokë, moti nxihet;
s'shuhen zjarret partizane dhe pse bie,
janë xhveshur ngrohen trimat në korie.

Dyshek borën nënëvete kanë shtruar,
jorgan një xhaketë ushtari të arnuar,
mbathur opinga lëkure shoshë çpuar,
pushkën mbështjellë pëqirit fort shtrënguar.

Pyjet me degët e tyre streh' u bënë.
Kudo çerdhe trimërie kanë qënë.

NDRIT VEPRA E DESHMOREVE

Zhulati i vogël në grykë
në mes të dy maleve,
pranë rravit shkëlqen ylli,
ndrit vepra e dëshmorëve.

Shtatë dëshmorë të rënë,
dhanë jetën për Atdhe
përmbi gjakun e kulluar
lulëzon jeta e re.

Cilin të përmend më parë?
Hasani ish shumë i ri;
djalë i vetëm i nënësë
atje mbi Senicë u shtri.

Mahmuti si vetëtima
çau përmes plumbave,
kur po hipte te bunkerit
u godit e ra përdhe.

Axhém Çela me Rushanë
tek sulmonin me furi,
përmbi tela në Tiranë
derdhën gjakun për liri.

Hamiti ish trim i rrallë,
komandant në kompani,
në sulm u godit në ballë
ra dëshmor në Mal të Zi.

ITALIANI S'DI KU SHKON

Majë malit është Picari,
Gjirokastra për karshi,
si rrufe shpërtheu zjarri,
Shefqet Peçi bën kërdi.

Kur dëgjohet tej Shefqeti,
që po vjen me batalion,
tundet vendi si tërmeti
italiani s'di nga shkon.

Shefqeti vjen që nga Kota
del me brigad' në Dalan
filloi që të dridhet toka
dhe për të famshmin gjerman.

LABJA BUZEQESHUR

Tetë ditë me radhë
qëndruan pa ngrënë,
vëndi plot nazistë,
shtigjet kishin zënë.

Një shtëpi çobani
ishte përkarshi,
nuk dukej nga shqopet,
tani ra në sy.

Atje miell s'gjetën
as për nji kulaç,
fëmijët t'uritur
shikonin mbi saç.

Labja buzëqeshur,
shokët sa i pa,
tepsinë me lakëra
nxori e ua dha.

POEZIJA NË KUADRA

Shokët që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë

Shokët që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë

Shokët që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë
nuk ka vajzë që nuk ka vajzë

ÇOBANI MORAVES

Tek mërxenim dhëntë
ndjen në befasi
se po lihnin qentë
nga përroi i Zi.

Sipër nga Morava
ujët gurë zbret
shtyn, përplas përpara,
shkëmbej tatëpjetë.

Çohet shpejt nga vendi
le gunën tek shtrunga,
të shpëtojë dhentë
qingjat nga furtuna.

Përroi ulërinte
tufa rrëth përpinqej
vetëtima shkreppte,
trimi nuk tërhiqej.

1970

SHKREPTE PËR QËM

“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”

“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”

“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”
“Dëshirat e vjetër”

POR TOKALLE E BOR SHIT

— Ku je nisur e do shkosh,
është larg, ku do qëndrosh,
o çoban i dhenetë.

— Atje në malet e larta,
në gusht dhent' nuk i zë vapa,
portokalle e Borshitë.

Tërë verën atje do rrimë,
nëpër çaj e trëndelinë,
ku ka thëllëza shtëpinë,
ujë bore do të pimë.

NË SHPELLËN E ARIUT

Te shpell' e ariut
hyn një nën' e gjorë
(shpella po derdh akuj
nata po derdh borë),

nxjerr te gryka pushkën,
fort në dorë e mba';
pushka ndizet vrullshëm —
shpella nji kala...

Hesht ky vogëlushi
në krahet e ngrohtë.
Nata është e egër,
nata është e ftohtë.

Tej jehojnë krismat
përzier me stuhi,
hesht ky vogëlushi,
pranë nënës rri.

Bora bie, bie
shpellës akuj ngrirë.
Lehtas syt e nënës
shuhën n'errësirë.

Era çirret grykës,
dukët sikur flet:
«Bir, ti kishe nënë,
tani nënë s'ke».

Prap' gjëmojnë malet,
partizanët vijnë,
përmes krisma pushkësh
bashkë me lirinë.

Era çirret grykës,
dukët sikur flet:
«Bir, ti kishe nënë,
sot vëllezër ke».

Dorën e ngre lart,
(lotët i janë tharë)
sikur bën betimin:
«Hakun do ta marr».

—
—
—
—

—
—
—
—

—
—
—
—

—
—
—
—

DASME PARTIZANE

Ç'dasmë bëre, Shero,
dasmë nëpër malet.
Kush i këndoi këngët,
kush i hoqi vallet?

Pa fustan të bardhë,
teminat s'të ndrinë,
oriz nuk të hodhën,
yllin në bustinë

Vello ti nuk kishe,
as krushq as dasmorë.
Vall'tarë t'u bënë
malet me dëborë

Uj'rat tē këndonin,
zajesh duke rendur,
pyjet iso mbanin,
si t'ishin tē dehur.

Bëre dasmë, Shero^{mānā},
dasmë nēpēr malet,
shokët morën këngën,
malet hoqen vallet.

lorod? orib? amash?
jelam? qib? den? as
sügööl? iebnööl? j? dars?
villay? lper? t? don?

Adina? Al? mānā? j?
Kan? bu? t? a? dars?
arilbaa? t? a? q?o
amash? t? a? q?

orib? den? t? a? q?
Biodash? en? p?as? t? a?
bu?d? t? a? q?
Biodash? en? p?as? t? a?

PLAGATE KURBETIT

O moj zagorjote ç'far' jete ke shkuar
në male të thata burrat të mërguar
për bukën e gojës burri në kurbet
harronte shtëpinë dhe gruan e shkretë.
Me një vit martesë mbahej mend rinia
tjetra mbetej shpresë sa vij pletëria.
Tani zagoriote sa paske ndryshuar
plaga e kurbetit të qënka shëruar
gra e burra tok punojnë të gëzuar

KAPOTA E GJATE

Kapota e gjatë
S'më harrohet kurër —
në sulmin mbi kodër
u shpalos flamur.

S'pushonte bunkeri,
por kapota gri
çante si shqiponja
për inat të tij!

Kapota e gjatë
grihet fare shoshë,
por s'vritet Resuli,
majën mb'rrin shëndoshë.

Pushoi mitralozi.
Monarkua e humbi...
Bën çudi Gramozi:
trimin s'e ha plumbi!

HËNË ME RRETH TË FLORINJTË

Hënë me rreth të florinjtë,
terrin mbuloje me dritë
edhe ktheje natën ditë;

hënë me rrëth të florinjtë,
mbi trase lësho ca dritë —
shkëmbin ta thërmojn' qysqitë;

hënë me rrëth të florinjtë,
nëpër ara lësho dritë,
që brigata të vaditë;

hënë me rrëth të florinjtë,
marinarit hidhi dritë —
të çaj' nëpër det stuhitë.

BEJK' E BARDHË E MALIT GJERË

Te kalaja kur më zbrite,
e vogla, çuditem se ku u rrite,
e vogla, moj bejka gjirokastrite,
e vogla,
bejk' e bardhë e Malit Gjerë,
e vogla, sa të zbardhin vato llërë,
e vogla, gush' e faqe, trupi i tërë,
e vogla,
bejk' e malit me aromë,
e vogla, nga napa e djathit t'njomë,
e vogla, po deshe një thel' dërgomë,
e vogla.

NE MES TE PAMBUKUT

Në piskun e vapës
të shikoj te dardha —
në bluzën e kuqe
dy lule të bardha,

bërë nga fabrika,
qëndisur ti vetë,
si gonxhe pambuku
me krye përpjetë.

Në mes të pambukut
prashit e shkul barë —
ma shton dhe më tepër
dashurinë e mallë.

HITO LABI

Malet e Lekdushit
ty t  b n  burr ,
plumbat e armikut
nuk t  tremb n kurr .

Dhe k rciti ashp r
pushka jote e rrall 
n  nj  dit  marsi,
se desh gjak n  ball .

E jehuan malet,
krism n sa d gjuan
e u mblozh n leb'rit —
k ng s ja filluan

«Atë ditë që hyri marsi
te Sulltani mb'rriti lajmi:
Gjirokastër u vra bimbashi
nga komiti Hito Labi»

Bien retë nga malet
e gjëmime sjellin
dhe prap' këngët labe
vrullshëm na mbështjellin;

pa ja nisin lebrit
sërish, si që moti:
Lule Hito Labi,
Hito lekdushjoti!

SHËRBETORJA

Thellë zemrës sate
kishe një dëshirë.
atdhenë të çliroje,
të ishe zogë e lirë;

sandallet ç'i veshe.
mbajte vesh një herë,
pe mos të përgjonin
dhe u bëre erë;

si flutur u nise
(udha ish e gjatë),
sandallet t'u shqyen
shtigjesh nëpër natë,

gërshetat ç't'u shpleksën,
qerpikët të rëndoijnë:
Vallë mos të ndjekin?
Vallë të kërkojnë?

Shpesh e ktheje kokën
dhe shikoje fshatin.
Malli s'të lëshonte.
po s'e ndalje hapin.

Pa të pyetën shokët
— E kujt je, na thuaj.
— Vërtet nuk më njihni?
Unë jam motra juaj.

NUK DO TË NDAHEM, MOLLEZE

Nuk do të ndahem, mollëzë,
mollë e Pogradecitë,
me fleta mbuluarë,
lëkurëlëmuarë,
fytyrëndriçuarë,
vende-vende skuqurë,
mjaltë në të kafshuarë!

NEPERKE E LIQENIT

Moj nepérka pika-pika,
nepérka e fushësë,
të keqen e gushësë.

moj nepérka lozonjare,
nepérka e ledhitë,
t'u dredhsha pas belitë.

ERDHËN DITE TË REJA

Ashtu ish zakoni tërkuzën e gjatë
çupës kur martohet ja vinish në pajë.

Që ditën e tretë nusja me tërkuzë
ngarkonte bucelën sa thyhei në gjunjë.

Të shkretën turkuzë e p'shelltë për mezi
kur ngarkonte drutë majës të një shkrepit.

O grua e shkretë tër' jetën sa rrove
me tërkuzë për gryke si mushkë u ngarkove.

Erdhën ditë të reja gruaja u çlirua,
me Partinë e saj është mish e thua.

KUR ISHA I VOGEL

Kur isha i vogël sa ma kishte ända
të loja. në shtrungë, të rrija te tënda,
të nagasja qenin lidhur te dëllenja,
e trembur nga ferra t'më dilte mëlljenja,
të v'reja n'ograje kec'rit që käcenin
të ngisja pas fluturave, që fort më pëlqenin.

ATE NATE MBI URE

Era ulërinte.
frynte si e marrë,
s'la pemë pa thyer,
por jo shokët tonë.

Fillon e vjen lumi,
dallga shkumëzon.
Kjo dallgë e tërbuar
armiqt' i tmerron.

Minat tejpërtej
urën e rrëzuan,
me të dhe nazistet
valët i mbuluan.

U NISËN KOPETË

U nisën kopetë shkojnë në mera
me zile këmborë ç'bukuri që ka.

Çobanin me qenin anash edhe mbrapa
ze vërvshëllen dhenve që s'ecnin nga vapa,
me mënga lëshuar të bardha si borë
qylahu mbi vetull kërrabën në dorë.

E ngjiti kopenë përpjet këmbës malit
nëpër trëndelinë ku fryn er' e barit;
bora maj Papingut vesin e kthen brymë
edhe vapës gushtit i lëshon freskinë.

Në malet e larta atje në mera
verojnë kopetë ç'bukuri që ka!

SI SHKËMB NË MES DALLGESH

C'kérkon breshkamadhi,
s'i harroi të vjetrat?
Le ta shohë prapë
si notojn' helmetat.

Po grin mitralozi,
hahen flákë pér flakë,
Fashist s'del i gjallë!
Dallga skuqet gjak.

Hekur-zjarr nga bregu
lëshon kjo frengjia,
si shkëmbi në mes dallgësh
qëndron Met Alia.

TEFIK' LAPANJIT

Dridh'shin malet rrotull
dhe Marinza dridhej,
por te bregu Cane
çet' e vogël hidhej.¹⁾

Ja Tefik Lapanji,²⁾
ballë çetën printe,
nuk dij ç'ishte plumbi,
ç'ishte vdekja s'dinte.

U vra... por nuk vdiq,
mbeti prap' i gjallë;
në çetën e vogël
u printe në ballë.

1) Çeta «Riza Cerova» është çeta që zbriti nga Skrapari dhe dogji kullat e bejlerëve në Myzeqe.

2) Tefik Riza Lapanji (dëshmor) u vra heroikisht në mars të vitit 1943 në përleshje që bëri çeta me mercenarët e Isa Toskës në krahinën e Roskovecit.

Atje në bregore
mbi barin e njomë,
lulkuqet e majit
pse s'kanë aromë?!

ATJE NË BREGORE

Atje në bregore,
mbi barin e njomë,
lulkuqet e majit
pse s'kanë aromë?!

S'pushon zemërjarri
me pushkë e granatë,
e kthen istikamin
në fortifikatë;

pastaj në t'aguar,
i goditur rëndë,
lë një amanet
për gruan e nënën:

Nënë mori nënë,
për mua mos vuaj,
çupën që kam lënë
dhe më fort ma duaj.

O grua e dashur,
O vëlla e atë,
mua në më doni,
shkoi në brigatë

F S H E S A R E

Fësh e fësh me fshesë,
kur të gjithë flenë,
trupi gjithë vesë
natënë me hënë...

Nënë dritë e hie
përkulur mbi fshesë,
e shoqja fshesare
mbuluar me diersë...

Netët fëshfërijnë
rrugëve në qytet,
bulevardet ndrinë
si mëngjez mbi det.

SHQIPONJA NË FLUTURIM

(Kushtuar Mustafa Matohitit)

Mal më mal të Labërisë
një shqiponjë fluturoi
i dërguari i Partisë
si bilbili ligjëroi.

Nëpër stane, ndër korie,
fshat më fshat s'pushoi.
si burimet në Lenie
fjalën e Partisë e çoi.

Sypatrembur, trim me fletë,
m'u në mes të ballit shkoi
gjuh' e tia shpatë e mprehtë,
Ali Benë demaskoi.

INFERMIERES PARTIZANE

Pishave të Vishigradit në lugina,
ku vërvhellente e oshëtinte suferina,
ngrinte jaka e kapotës nga borima,
ktheheshin trimat shpesh nga lufta të plagosur
e nga dhembja qante bora e gjakosur.
Infermieret nat' e ditë i mjekonin
motra s'ishin, por dhe motrës ia kalonin,
shtatë male pa u ankuar i kaptonin!
Pishave të Vishigradit në lugina
vërvhellente, oshëtinte, suferina,
dridheshin malet si frikace nga bubullimat.

DOLLA TE MURRIZI

Dola të murrizi, pashë një tufë me pela,
disa në livadhe, të tjerat në lera:
qimet për së largu në trup u shkëlqenin,
lelet mënjanë si bukle m'i kthenin.
Një mëze e vogël me pika në ballë
qe shtrirë në luadh, ç'bukuri e rrallë!
Në barin e njomë përmbi trëndelinë
nga mëzja e vogël s'e hiqja dot synë.

MUHO HAZIZIT

Durove urinë
zhveshur nëpër shi,
me këmbë të ngrira
shkove në veri;
në qdo luftë i pari
do sulmoje ti,
armikut s'iu ndave
në Jugosllavi,
 trimi i tërbuar,
 Muho Hazizi.

Në tokë të huaj
mbete me lavdi:
yll në Cernagorë,
yll në Shqipëri.

MELODISEË SE ÇOBANIT

Do ia marr e s'ia marr fare
për qejf të cules dyare...

Me atë cule bariu
majave, ku fryn veriu,

këndon malit bukurisë,
tufave të bagëtisë.

Culja s'pushon asnjëherë,
si në dimër dhe në verë;

ç'të kënaq me melodinë
kur ia thotë për partinë!

BURG DEMIRIT

Kallarati këtë herë
o shokë more
ka nxjerrë trima tē tjerë
o shokë more
Burg Demirinë me vlerë
o shokë more
ju qep shkëmbit posi ferrë
o shokë more
në Dukaj në Tepelenë
o shokë more
me bomba e revolverë
o shokë more
u hodh sipër mbi rrebelë
o shokë more
për Partinë si pranverë
o shokë more
me gjak e vesiti dhenë
o shokë more.

THONË PLAKAT BUBU-BU

Vaj o vaj dynja e parë,
për tumanet zvarrë-varrë..
Dymb'dhjet' metra s'qe shaka,
modë turku për sevda!
Thonë plakat: Bubu-bu,
kërcinj jashtë, fustan mbi gju,
van' tumanet e mëdhaja,
po prishet fare dynjaja!

QAFÈ LESHIT

O kalesh, more kalesh,
qafa mbuluar me lesh,
s'të duket fytyr' as vesh.

Favoritej gjer në gojë,
pantallonat kauboj,
llap' e gjatë katër pëllëmbë
tundet si thes nëpër këmbë;

me rryp të gjer', or qyqar,
s'na le palldëm për gomar.

C'kapardise qosh më qosh,
karnaval me kokë bosh!
Nuk po sheh, t'u thaftë koka,
nga ne mëson gjith' Evropa?

NE BALLKON MË ZGJON BILBILI

Këndon bilbili në shegë,
nga gjumi më zgjon,
në ballkon përmbi një degë
me atë zë më shëron.

O bilbil i bukurë,
mos isha zbuluarë?

— Ashtu ishe, zogëzë,
zbuluarë e zhveshurë,
më linjë shpërveshurë;
zogë, unë të mbulova
edhe shegët s't'i trazova

PULË E MILLONAIT

Te porta jeshile më rrive karshi,
pul' e millonait, në mendje ç'më rri.

Dashurin' që ndjenim e shprehnim me sy,
pul' e millonait, zemra rreh për ty.

Unë në dritare, ti nëpër avlli,
pul' e millonait, në mendje më rri.

Si prush i mbuluar digjeshim të dy,
pul' e millonait, zemra rreh për ty.

Dil një her' nga lëmi se nuk ka njeri.
Bota ç'far' do thonë? Kemi dashuri.

Do të vijë dita të marr në shtëpi,
pul' e millionait, në zemër ç'më rri.

O TRENDAFIL ME ERË

O trëndafili me erë,
çel pranverë në pranverë,

trëndafil i kuq i bardhë,
përher' në dorë të mbaj,

trëndafili fletëkuq,
për er' të vë në sënduq,

o trëndafili me erë,
do vij të futem në ferrë,
dërsitur, këmishëçjerrë,
ç'më kënaq me atë erë!

S'BËHEM NUSE ME PAHIRE

Bien sazet, krushqit vinë,
plot e përplot një maqinë,
për të marrë Mahmudinë.

Mahmudia s'është mirë,
në fytyrë është nxirë,
thotë «burri s'është i mirë,

Më fejuan pa dëshirë.
s'bëhem nuse me pahirë,
nuk kam frikë sot, jam e lirë!

JASTEKU I KUQ ME LULE

O jastëku palë - palë,
m'u trashëgofsh moj vajzë,

o jastëk i kuq me lule,
të bukur djalë na zure,

o jastëku fletë-fletë,
çift u trashëgofsh për jetë.

TREGOME KU E KE SHTEPINE

Trendelinë o trendelinë,
tregomë ku e ke shtëpinë,
të të vij natën pa gdhirë.

— Te porta me llamarinë,
po s'e kalon dot avllinë,
s'e këput balua zinxhirë.

PLAKAT —O

Plakat-o, plakat-o
vajtojnë të vjetrat-o,
që rrëmbenin drurin-o
dhe qëllonin nuset-o.
vajtojnë kohën e parë,
me kyç e mbanin qilarë,
kohën e parë vajtojnë,
nuset më romuz thumbojnë.

FLUTURE

Fluturë o fluturë,
ç'më je kaq e bukurë,
nëpër lule ngjyerë,
me bojra përzierë,
rrezaton me diellë,
fluturon meskëputurë,
mos më rri e truarë,
se me dorë nuk të zë.

PËR PRANVERAT QË NA VIJNË

Do këndo si bilbil mali
për qejf të këtij behari,
për pranverat që na vijnë,
se na sjellin begatinë, —
kopsht me lule Shqipërinë.
Të gjithë ja kanë zilinë,
Ndaj do këndo pér partinë,
pér pranverat që na vijnë,
rrofsh pér jetë, Enveri ynë!

PELLUMBI

O pëllumbi në ballkon,
shpirtin tim ti e shëron,
pëllumbi krahëshigjetë,
në dritare kur troket,
zemra më hidhet përpjetë.
Po s'i kam krahët me fletë —
të fluturonim përpjetë,
Të fshiheshim të dy te retë.

GWUNDYLLIE HENE

— Dëgjova tē fliste mëma,
pse shkova natën nga lëma,
grykëzënë,
ndrit si hënë.

— Do ta dish ku isha mbrëmë?
Un' kam tezen përmbi lëmë.
o zog pylli,
ndrit si ylli.

Po këto fjalë t'i lëmë
dhe tē rrim'bashkë në lëmë,
yll e hënë,
yll e hënë.

LEKDUSHI I HERONJVE

Në Plajë të Limerit,
nën shkëmbinjtë përqark,
Lekdushi i heronjve
flet me ballin lart.

Pesë herë u dogje,
çatitë morën zjarr,
muret imbetën në këmbë
prapë si dëshmitare;

tre dimra s'u drodhe,
zjarr kishe në gji,
si shkëmbi qëndrove
kala për liri.

Si thosh Mustafai
po bëhe tani,
fshati si qyteti
ndrit në Labëri.

TRADUCTION :

Si thosh Mustafai
po bëhe tani,
fshati si qyteti
ndrit në Labëri.

Si t'as i përfunduar viti i shkurtit, po
nëntorin e së ardhur, që nuk ka
qenë e përshtatshme që të jepim
një mësim, që është këtia që:
Aksidentet e ndryshme janë vërtet e
dëmja, por jo vërtet që i dëmja
janë mësimet e kësaj përkohë. Dëmja
janë mësimet e kësaj përkohë. Dëmja
janë mësimet e kësaj përkohë. Dëmja

7512 00000 0000 0000 0000 0000 0000 0000 0000 0000 0000 0000

KËRPUDHAT

Një tufë te rrëza u pa që nga udha,
dukeshin si çadra, qenkeshin kërpudha;
të bardha, të kuqe, të buta, të lehta,
ngjanin si simite kërpudhat e shkreta!
Mbi prush merrnin faqe dhe shije të mirë,
sì petulla të fryra lëshonin yndyrë.
Në mal të Çuçelit¹⁾, ku prekeshin retë,
buk' s'kish partizani, haj ç'kishte mbi dhetë,
gjunjët nuk i priteshin, sulmon si shigjetë!

1) Maja Çuçelit ka një lartësi 1476 metra. Është afër
katundit Gojan.

CINXERI PIKALOSH

O more cinxër që këndon,
ç'thashetheme fabrikon,
të gjithë nëpër gojë i shkon,
si nëpërkë i thumbon.
pa një bisht asnje s'harron;

o cinxéri pikalosh,
nuk pushove qosh më qosh
dhe në varr do cicërrosh!

KAMBER ZENELI

Fusha e Romësit ç'u zgjua,
nga dhembja krejt u pushtua...
Kamberi me shtat të gjatë...
I ndrit nuri këtë natë.
S'e tremb karabineria,
as vdekja nga breshëria,
Kamberi si shkëmb i rëndë
vdekjen pret si lis më këmbë.
Fusha e Remisit ç'u zgjua,
po thur këngën tok me mua.

OB	osmisiq kacitun qat
OB	isurura si libet
OB	ja kastri edem
OB	flasdo si balec M
OB	shemec mund
OB	adje nq sene
OB	hilesi QO
OB	Hidhet noga om neallar
OB	simofira o bluz
Bie bora flokë-flokë	3	
Ndrit vepra e dëshmorëve	4	
Italjani s'di ku shkon	6	
Labja buzëqeshur	7	
Çobani Moravës	9	
Portokalle e Borshitë	11	
Në shpellën e ariut	12	
Dasmë partizane	15	
Plaga e kurbetit	17	
Kapotë e gjatë	18	
Hënë më rrëth të florinjtë	20	
Bojk' e bardhë e malit gjerë	21	
Në mes të pambukut	22	
Hito Labi	23	
Shërbëtorja	25	
Nuk do të ndahem mollëzë	27	
Nepërkë e liqenit	28	
Erdhën ditë të reja	29	
Kur isha i vogël	30	
Atë natë mbi urë	31	
U nisen kopetë	32	
Si shkëmb në mes dallgësh	33	
Tefik Lapanjti	34	
Atje në bregore	35	
Fshesare	37	
Shqiponja në fluturim	38	

Faqe

Infermijeres partizane	39
Dolla te murrizi	40
Muho Hazizit	41
Melodisë së çobanit	42
Burg Demirit	43
Thonë plakat bubu-bu	44
Qafë leshit	45
Në ballkon më zgjon bilbili	46
Pulë e millionait	47
O trëndafil me erë	49
S'bëhem nuse me pahir	50
Jastëku i kuq me lule	51
Tregomë ku e ke shtëpinë	52
Plakat-o	53
Fluturë	54
Për pranverat që na vinë	55
Pëllumbi	56
Yll' e hënë	57
Lekdushi i heronjve	58
Kërpudhat	60
Cinxeri pikalosh	61
Kamber Zeneli	62

63

64

65

66

67

68

69

70

71

72

73

74

75

